



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. 449/6 prot.

Tiranë, 20.11.2018

- Lënda:** Ankim i Komisionerit Publik kundër vendimit nr. 63, datë 6.8.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit z. Arben Dollapaj
- Baza ligjore:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”
- Për kompetencë:** Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese
- Për dijeni:** Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit
- Depozituar pranë:** Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

Të nderuar zonja/zotërinj, gjyqtarë të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese,

Në zbatim të nenit 55, pika 7 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, në datë 5.11.2018, është njoftuar vendimi nr. 63, datë 6.8.2018, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për subjektin në rivlerësim z. Arben Dollapaj, Prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Shkodër.

Komisioneri Publik, në mbështetje të nenit C, pika 2, nenit F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, ka të drejtë të ankimojë vendimin brenda afatit 15-ditor nga njoftimi.

Brenda afati ligjor, unë, Komisioneri Publik Florian Ballhysa, ushtroj ankim ndaj vendimit nr. 63 datë 6.8.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

### **I. Procesi i rivlerësimit dhe përfundimet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit**

**1.** Subjekti i rivlerësimit, z. Arben Dollapaj, ushtron detyrën e Prokurorit në Gjykatën e Apelit Shkodër dhe, në bazë të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës, i është nënshtuar procesit të rivlerësimit *ex officio* me përparësi në kohë. Duke qenë kandidat për anëtar në Këshillin e Lartë

të Prokurorisë, në bazë të nenit 279, të ligjit 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit me përparësi në kohë.

2. Subjekti i rivlerësimit ka punuar si Prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pukë, në vitet 1993-1996, Prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kukës, në vitet 1996 - 1998, drejtues në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnjë, në vitet 1998 - 2000, drejtues në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, në vitet 2000 - 2004, Prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, në vitet 2004 - 2008, Prokuror në Prokurorinë e Përgjithshme, drejtues drejtorie, në vitet 2008 - 2016, Prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Shkodër, në vitet 2016 - në vazhdim.

3. Mbështetur në nenin Ç, pika 1 e aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit ndaj z. Arben Dollapaj ka përfshirë kontrollin dhe rivlerësimin e të tria kriterëve, atë të pasurisë, figurës dhe aftësive profesionale. Për këtë qëllim, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim referuar si Komisioni) ka administruar raportet e vlerësimit të hartuara për këtë subjekt nga institucionet ndihmëse, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim referuar si ILDKPKI), raportin e vlerësimit të figurës nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim referuar si DSIK) dhe raportin e vlerësimit profesional nga grupi i punës në Prokurorinë e Përgjithshme (në vijim referuar si Prokuroria e Përgjithshme), nga të cilat rezultojnë se:

3.1 ILDKPKI, bazuar në nenin 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, me anë të “Aktit të përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë për subjektin Arben Dollapaj<sup>1</sup>”, ka referuar se:

- i. Deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;
- ii. Ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- iii. Nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- iv. Nuk ka kryer deklaram të rremë;
- v. Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

3.2 DSIK, bazuar në nenin 39, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, me anë të raportit mbi kontrollin e figurës për subjektin<sup>2</sup>, ka referuar “Përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës”.

3.3 Prokuroria e Përgjithshme, bazuar në nenin 43, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, ka përcjellë pranë Komisionit raportin për analizimin e aftësive profesionale të subjektit<sup>3</sup>, nga analiza e të cilit, së bashku me vlerësimin e denoncimeve nga publiku (1 i tillë), Komisioni nuk ka gjetur elemente që mund të ngrenë dyshime për aftësinë profesionale apo cilësi që cenojnë figurën e subjektit të rivlerësimit, duke arritur në konkluzionin se subjekti ka arritur një nivel minimal kualifikues vlerësimi të aftësive profesionale.

4. Komisioni, pas hetimit administrativ dhe vlerësimit të fakteve dhe rrethanave lidhur me kontrollin e pasurisë, figurës dhe aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, për secilin kriter, në mënyrë të përmbledhur, ka arritur në përfundimet si vijon:

4.1 **Për vlerësimin e pasurisë.** Referuar nenit D të aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, hetimi administrativ i Komisionit është shtrirë në kontrollin e gjendjes pasurore të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të, saktësinë dhe mjaftueshmërinë e deklarimeve periodike të interesave pasurore krahasuar me atë “Vetting”, ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë, ligjshmërinë e të ardhurave, shpenzimet dhe pagimin e detyrimeve financiare për subjektin e rivlerësimit dhe personat e lidhur me të.

<sup>1</sup> Shkresa e ILDKPKI nr. \*\*\* prot, datë \*\*\*.11.2017.

<sup>2</sup> Shkresa e DSIK me nr.\*\*\* prot., datë \*\*\*.10.2017 (deklasifikuar).

<sup>3</sup> Shkresa e grupit të punës në Prokurorinë e Përgjithshme nr. \*\*\* prot., datë \*\*\*.12.2017.

**4.2** Komisioni, referuar aneksit të Kushtetutës (neni D), ligjit nr. 84/2016 (kreu IV), lidhur me kriterin e pasurisë, bazuar në vlerësimin tërësor të rrethanave të çështjes, provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, shpjegimet e subjektit të rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe pasi ka marrë në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, konkludon në vendimin e tij se subjekti i rivlerësimit, z. Arben Dollapaj:

- a) ka pasaktësi në deklarime;
- b) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- c) nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- d) nuk ka kryer deklarim të rremë;
- e) nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.

**4.3** Në këto kushte, Komisioni ka vlerësuar se subjekti i rivlerësimit, z. Arben Dollapaj, ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas dispozitës së nenit 59/1, germa “a”, të ligjit nr. 84/2016.

**4.4 Për kontrollin e figurës.** Referuar nenit DH të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 39 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni ka konstatuar se nuk është gjetur asnjë element që të vërtetojë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme të subjektit të rivlerësimit, duke konkluduar se subjekti ka arritur nivel të besueshëm dhe është në kushtet e përshtatshme për vazhdimin e detyrës si Prokuror.

**4.5 Për vlerësimin e aftësive profesionale.** Referuar nenit E të aneksit të Kushtetutës, nenit 43/2 dhe 44 të ligjit nr. 84/2016 dhe kreut II, pjesa IV të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH”, i ndryshuar, Komisioni, pasi ka administruar raportin e përgatitur nga grupi i punës në Prokurorinë e Përgjithshme<sup>4</sup>, hetimit dhe vlerësimit të një denoncimi nga publiku dhe rekomandimin nga ana e relatorit të çështjes, ka arritur në konkluzionin se nuk është gjetur asnjë indicie apo element që mund të ngrejë dyshime për aftësinë profesionale apo cilësi që cenojnë figurën e subjektit të rivlerësimit. Sipas Komisionit, subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel minimal kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, referuar nenit 59, pika 1, germa “c” e ligjit nr. 84/2016.

**5. Vendimi i Komisionit.** Nisur nga përfundimet e mësipërme për secilin kriter kontrolli, bazuar në nenin 58, pika 1, germa “a”, dhe nenin 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, Komisioni ka vendosur konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Arben Dollapaj, me funksion Prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Shkodër.

## **II. Shkaqet e ankimit**

**6.** Në kuptim të nenit 179/b të Kushtetutës, aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioneri Publik është një nga tri institucionet që kryejnë procesin e rivlerësimit kalimtar (Vetting).

**7.** Bazuar në këto parashikime kushtetuese dhe ligjore, Komisionerit Publik, si përfaqësues i interesit publik në kryerjen e këtij procesi, i njihet e drejta e ankimit kundër vendimeve të Komisionit, pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit (në vijim referuar si Kolegji).

**8.** Në krahasim me kompetencat kushtetuese dhe ligjore që u njihen Komisionit dhe Kolegjit nga neni Ç i aneksit të Kushtetutës, nenet 48 - 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik është i detyruar që kompetencën e tij për të ushtruar ankim ndaj vendimeve të Komisionit ta mbështesë vetëm në aktet dhe provat e administruara gjatë kryerjes së procesit

---

<sup>4</sup> Bazuar në formularin e vetëdeklarimit, 3 dokumente ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit, si dhe 5 dosje penale të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor. Të dhëna nga burimet arkivore të Sektorit të Burimeve Njerëzore në Prokurorinë e Përgjithshme.

të rivlerësimit nga ana e këtij të fundit, pa pasur mundësinë ai vetë (Komisioneri) që të ketë akses në burimet e informacionit dhe të disponojë për marrjen e provave.

**9.** Në të tilla rrethana ligjore, me qëllim garantimin e mbrojtjes së interesit publik gjatë procesit të rivlerësimit, Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, duke vlerësuar nëse vendimmarrja e tij është në përputhje me kërkesat kushtetuese e ligjore, bazohet në një hetim administrativ të gjithanshëm e shterues dhe vlerësim të drejtë të provave.

**10.** Edhe në rastin konkret, Komisioneri Publik, bazuar në kompetencën e tij kushtetuese dhe ligjore, nga shqyrtimi i vendimit nr. 63, datë 6.8.2018, dhe provave të administruara për këtë qëllim nga Komisioni, vlerëson se vendimi përmban shkaqe të mjaftueshme për t'iu paraqitur juridiksionit kontrollues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

**10.1** Nisur nga hetimi dhe vlerësimi që ka kryer Komisioni për të tria kriteret e rivlerësimit, Komisioneri Publik konstaton se, për sa i takon vlerësimin të pasurisë, bazuar në kërkesat e nenit D të aneksit të Kushtetutës dhe kreut IV të ligjit nr. 84/2016, përfundimet e Komisionit për këtë kriter rivlerësimi ndaj subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të, nuk gjejnë mbështetje të plotë në aktet dhe provat e administruara. Gjatë kryerjes së procedurave të rivlerësimit, sikurse u tha më lart në këtë ankim, objekti i hetimit dhe i vlerësimit të pasurisë ndaj subjekteve që i nënshtrohen këtij procesi, sipas nenit 179/b të Kushtetutës, materializohet në kontrollin dhe hetimin e saktësisë dhe mjaftueshmërisë së deklarimeve, kontrollin e pasurisë, ligjshmërisë së burimit të krijimit të saj dhe i përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë të subjektit dhe personave të lidhur me të.

**10.2** Sa më sipër, Komisioneri Publik çmon se procesi i hetimit, i kryer nga Komisioni për kriterin e vlerësimit të pasurisë, nuk ka qenë i plotë e, për rrjedhojë, përfundimet e arritura nuk janë në pajtueshmëri me provat e administruara. Në rastin konkret, hetimi i paplotë për kriterin e rivlerësimit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit lidhet dhe ndikon në mënyrë të detyrueshme në hetimin e kriterit të figurës dhe profesionalizmit.

**10.3** Komisioneri Publik, nëpërmjet këtij mjeti procedural (ankimit), në respektim të kërkesave kushtetuese e ligjore për rivlerësimin kalimtar të subjekteve dhe në mbrojtje të interesit publik, synon kontrollin e vendimit nr. 63 datë 6.8.2018, të Komisionit nga ana e Kolegjit, lidhur me nevojën e hetimit të mëtejshëm të deklarimeve të subjektit të rivlerësimit, personave të lidhur, klasifikimit si “persona të tjerë të lidhur” të subjekteve, që rezultojnë se kanë lidhje të tilla me subjektin e rivlerësimit, administrimin e provave për të identifikuar mënyrën e krijimit të pasurisë/likuiditeteve, me qëllim justifikimin bindshëm të burimit të krijimit sipas nenit D të aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016.

**10.4** Në rastin konkret, nevoja e hetimit të kriterit të pasurisë, për subjektin e rivlerësimit z. Arben Dollapaj, për sa kohë në vlerësimin e Komisionerit Publik lidhet dhe (i) me klasifikimin si “persona të tjerë të lidhur”, të subjekteve që nuk janë konsideruar si të tillë nga ana e Komisionit, gjatë hetimit përkatës administrativ, si dhe (ii) hetimin e rrethanave të caktuara ligjore, që ndikojnë në vlerësimin e etikës dhe integritetit të subjektit të rivlerësimit, lidhet në mënyrë të pashmangshme dhe me nevojën për hetimin e dy kritereve të tjera të rivlerësimit, atë të figurës dhe aftësive profesionale.

**11.** Në këto kushte, bazuar në nenin C, pika 2, nenin F, pikat 3 dhe 7 të aneksit të Kushtetutës si dhe nenit 4 dhe 66 të ligjit nr. 84/2016, ky ankim i Komisionerit Publik ndaj vendimit nr. 63, datë 6.8.2018, të Komisionit, ushtrohet për të tria kriteret e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit z. Arben Dollapaj.

## II.A. Vlerësimi i Komisionerit Publik

1. Komisioneri Publik konstaton se procesi i hetimit i Komisionit, për të tria kriteret e rivlerësimit, ka mangësi dhe, për rrjedhojë, në gjendjen që janë aktet nuk mund të konkludohet se subjekti i rivlerësimit është në kushtet e parashikuara nga neni 59, pika 1, e ligjit nr. 84/2016.

2. Në të tilla rrethana, Komisioneri Publik vlerëson se nëpërmjet këtij instrumenti procedural (ankim) do të bëhet e mundur që këto mangësi të vërejtura gjatë hetimit administrativ, nga ana e Komisionit, të mund të riparohen gjatë shqyrtimit të ankimit nga ana e Kolegjit.

3. Kolegji, sipas parashikimit të nenit F, pika 3 të aneksit të Kushtetutës, citon: “...mund të kërkojë mbledhjen e fakteve ose të provave, si dhe të korrigjojë çdo gabim procedural të kryer nga ana e Komisionit, duke mbajtur parasysh të drejtat themelore të subjektit të rivlerësuar. Kolegji vendos në lidhje me çështjen dhe nuk mund t’ia kthejë atë Komisionit për rishqyrtim. Juridiksioni kushtetues nuk lejon të vihen në diskutim parimet e kushtetutshmërisë, mbi të cilat është bazuar procesi i rivlerësimit dhe, si i tillë, bazohet të kriteret e përcaktuara në këtë ligj”.

4. Në këto kushte, bazuar në nenin C, pika 2, nenin F, pikat 3 dhe 7, të aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 4 dhe 66 të ligjit nr. 84/2016, në vijim paraqesim vlerësimin dhe shkaqet e ankimit për secilin aset pasuror, në pronësi apo përdorim të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të, vlerësimin mbi ligjshmërinë e burimit të krijimit të tyre, lidhjen me dy kriteret e tjera të rivlerësimit dhe nevojën për hetimin e të gjitha kriterëve të rivlerësimit nga ana e Kolegjit.

## II.B Vlerësimi mbi pasuritë e paluajtshme

5. Pasuritë nga subjekti i rivlerësimit, z. Arben Dollapaj, janë deklaruar fillimisht në *Deklaratën e personit që mbart detyrimin për deklarim pasurie* (këtu e në vijim referuar si Deklaratë e vitit 2003), dorëzuar në ILDKP, më datë \*\*\*.3.2004, deklaratat periodike për vitet 2004 - 2016 dhe në *Deklaratën “Vetting”*, dorëzuar në ILDKPKI, në datë \*\*\*.1.2017. Pasuritë e deklaruara, janë si vijon:

### 5.1 Pasuria 1

**Shtëpi banimi në rrugën “\*\*\*\* \*\*” (\*\*\*) (\*\*\*) \*\*\*) \*\*\*) \*\*\*) \*\*, \*\*)**

- Në deklaratën “Vetting” deklarohet: Shtëpi banimi me sipërfaqe ndërtimi 113 m<sup>2</sup>, me vendndodhje rruga “\*\*\*\* \*\*”, \*\*\*) \*\*\*) \*\*\*) \*\*, me vlerë 9.000.000 lekë. Pjesët takuese 20 %. Burimi i krijimit të pasurisë nuk përshkruhet.

- Në deklaratën periodike të vitit 2007 deklarohet: Shtesë kati me sipërfaqe 113 m<sup>2</sup>, me vendndodhje rruga “\*\*\*\* \*\*”, \*\*\*) \*\*\*) \*\*\*) \*\*, në banesën e vëllait, z. \*\*\*) \*\*\*) \*\*, me vlerë 1.700.000 lekë. Pjesët takuese 100%. Burim i krijimit të pasurisë nuk përshkruhet.

- Në deklaratën periodike të vitit 2011 deklarohet: Blerje sipërfaqe banimi prej ½ e 113 m<sup>2</sup>, dhe truall 157 m<sup>2</sup>, me vendndodhje rruga “\*\*\*\* \*\*”, \*\*\*) \*\*\*) \*\*\*) \*\*, me vlerë 9.000.000 lekë. Pjesët takuese 100%. Si burim i krijimit të pasurisë është deklaruar: (i) kursime personale 1.500.000 lekë, (ii) hua në shumën 25.000 USD, (iii) kredi në shumën 5.000.000 lekë.

### 5.1.1 Akte të administruara në dosjen e Komisionit, ndër të tjera, janë:

- i Shkresë me nr.\*\*\* prot., datë \*\*\*.9.2017, e ZVRPP-së \*\*\*, shoqëruar me kartelën e pasurisë së paluajtshme të datës \*\*\*.9.2017.
- ii Kontratë shitblerje me nr.\*\*\* rep., nr.\*\*\* kol., datë \*\*\*.3.2011, lidhur në \*\*\* para noterit \*\*\* \*\*\*. Palë shitës \*\*\* \*\*\* dhe palë blerës Arben Dollapaj, objekti shitblerje e ½ të sipërfaqes së ndërtimit prej 113 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqes truall prej 157 m<sup>2</sup>, me vendndodhje rruga “\*\*\* \*\*\*”, \*\*\* \*\*\*, \*\*\*. Çmimi i shitjes 9.000.000 lekë.
- iii Kontratë kredie bankare me nr.\*\*\* rep., nr.\*\*\* kol., datë \*\*\*.5.2011, lidhur në \*\*\*, para noterit \*\*\* \*\*\* me kredidhënës \*\*\* \*\*\*, kredimarrës Arben Dollapaj, dorëzanës \*\*\* \*\*\* dhe \*\*\* \*\*\*, me objekt akordimin në favor të kredimarrësit një total kreditimi në shumën 5.000.000 lekë për blerje shtëpie. Garancia për këtë kredi është hipotekimi i pasurisë së paluajtshme “Truall dhe ndërtesë”, me sipërfaqe 270 m<sup>2</sup> dhe 113 m<sup>2</sup>.
- iv Deklaratë e thjeshtë e shtetasit \*\*\* \*\*\* (pa datë) mbi huan prej 25.000 USD, dokumentacion bankar mbi transferimin e shumës për subjektin e rivlerësimit z. Arben Dollapaj dhe deklarimet për shlyerjen prej 20.000USD.
- v Dokumentacion mbi pronësinë e pasurisë nr.\*\*\*, z. k. \*\*\*, ZVRPP \*\*\*.
- vi Vetëdeklarim “Për legalizimin e shtesës”, i datës \*\*\*.11.2006, në emër të subjektit të rivlerësimit z. Arben Dollapaj.
- vii Faturë për arkëtim, e datës \*\*\*.3.2011, në \*\*\* \*\*\*, për llogari të ALUIZNI-t \*\*\*, me përshkrimin “tarifë shërbimi për legalizim, penalitete për vonesë në vetëdeklarim, taksë ndikimi në infrastrukturë”.
- viii Leje legalizimi nr.\*\*\*, datë \*\*\*.7.2012, në emër të z. Arben dhe \*\*\* Dollapaj, për një sipërfaqe ndërtimi 128,43 m<sup>2</sup> për banim.
- ix Kontratë shitblerje me nr.\*\*\* rep., nr.\*\*\* kol., datë \*\*\*.7.2004, lidhur në \*\*\*, para noterit \*\*\* \*\*\*, palë shitës z. \*\*\* \*\*\* dhe palë blerës z. \*\*\* \*\*\*, objekti shitblerje trualli dhe shtëpia 2 (dy) kate, e ngritur mbi të, me sipërfaqe ndërtimi prej 113 m<sup>2</sup>, me vendndodhje rruga “\*\*\* \*\*\*”, \*\*\* \*\*\*, \*\*\*. Çmimi i shitjes 3.900.000 lekë. Likuidimi është bërë CASH në dorë jashtë zyrës noteriale.
- x Shkresë me nr.\*\*\* prot., datë \*\*\*.1.2018, e ZVRPP \*\*\*, shoqëruar me kopje të dokumentacionit, ku, ndërmjet të tjerash, është aktkolaudimi tekniko-ekonomik, i datës \*\*\*.11.1998, për banesën 2 kate.

**5.1.1/1** Nga dokumentacioni i përcjellë nga ZVRPP \*\*\*<sup>5</sup>, rezulton se vëllai i subjektit, z. \*\*\*.\*\*\*, e ka fituar titullin e pronësisë mbi ndërtesën dykatëshe rr.”\*\*\* \*\*”, \*\*\* \*\*\*, \*\*\*, në datë \*\*\*.7.2004, bazuar në një kontratë shitblerje të përshkruar dhe më lart, me palë shitëse shtetasin z.\*\*\* \*\*\*. Shitësi z. \*\*\* \*\*\* e ka regjistruar pronësinë në ZVRPP \*\*\*, vetëm një muaj përpara kryerjes së kësaj shitje, në qershor 2004.

**5.1.1/2** Nga aktet e administruara nga korrespondenca zyrtare e Komisionit me ZVRPP \*\*\*, mbi origjinën e pronës për shitësin, për këtë pasuri rezulton se ka pasur një konflikt gjyqësor me paditës z. \*\*\* \*\*\* (shitësi) dhe të paditur \*\*\* \*\*\* dhe \*\*\* \*\*\*. Me vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë \*\*\* nr.\*\*\*, datë \*\*\*.4.2004, të paditurit \*\*\* \*\*\* dhe \*\*\* \*\*\* kanë njohur pronar shtetasin \*\*\* \*\*\*<sup>6</sup> mbi një shtëpi banimi 2 kate, plus 1 kat çati, ku secili kat ka 3 dhoma, banjë, dy veranda, ballkon me sip. ndërtimore 113 m<sup>2</sup>. Vendimi ka marrë formë të prerë në datë \*\*\*.6.2004, duke u bërë kështu i ekzekutueshëm.

<sup>5</sup> Me shkresën ZVRPP \*\*\* nr. \*\*\* prot., datë \*\*\*.1.2018.

<sup>6</sup> Shitësi, shtetasi \*\*\*.\*\*\*., rezident në \*\*\*, ia ka shitur pronën vëllait të subjektit, z.\*\*\*.\*\*\*.

**5.1.1/3** Në deklaratën e vitit 2003, dorëzuar në ILDKPKI, më datë \*\*\*.3.2004, rezulton se subjekti i rivlerësimit z. Arben Dollapaj ka deklaruar si vendbanim të tij, pikërisht adresën e mësipërme, rr. “\*\*\* \*\*”, \*\*\* \*\* \*\*\*, \*\*\*. Kjo adresë është adresa e banesës 2-katëshe, pronësinë e së cilës rezulton se vëllai i subjektit të rivlerësimit e ka fituar rreth tre muaj më vonë, sesa subjekti i rivlerësimit ta ketë deklaruar si vendbanim të tij dhe familjes së tij.

**5.1.1/4** Në deklaratën e interesave periodikë të vitit 2007, subjekti deklaroi për herë të parë “shtesë 1 kat për banim në objektin ekzistues 2 kate”, e papërfunduar, me vlerë 1.700.000 lekë, ndodhur në \*\*\*. Ndërsa në deklaratën “Vetting”, kjo pasuri rezulton e padeklaruar, edhe pse subjekti kishte detyrimin të deklaronte saktësisht dhe plotësisht pasuritë e paluajtshme, deri në datën e dorëzimit të deklaratës në përputhje me nenin D të aneksit të Kushtetutës, ligjin nr. 84/2016 dhe udhëzimin e ILDKPKI-së, datë 10.10.2016.

**5.1.2 Në vlerësimin e Komisionerit Publik**, mangësitë e hetimit nga ana e Komisionit për këtë pasuri qëndrojnë në pesë elemente: (1) justifikimit të krijimit të kësaj pasurie me burime të ligjshme për shumën 25.000 USD, hua nga shtetasi \*\*\* \*\*\*, rezident në \*\*\* \*\* \*\*\*, (2) veprimeve fiktive në përfitimin e kredisë nga \*\*\* \*\* \*\*\*, për shumën 5.000.000 lekë, (3) kualifikimit si person tjetër të lidhur për këtë pasuri të shtetasit \*\*\* \*\*\* (i vëllai), (4) mospërputhje në deklarim për pjesët takuese; (5) hetim në lidhje me ekzistencën e situatën e konfliktit të interesave me z. \*\*\* \*\*\* dhe verifikimin e rekordeve eventuale të këtij shtetasi në institucionet përkatëse, sikundër parashikohet në ligj.

#### **(1) Huaja 25.000 USD**

**5.1.2/1** Komisioni, megjithëse ka qenë në rrethanat ligjore të vërtetuara gjatë hetimit administrativ, nuk ka bërë kualifikimin e z. \*\*\* \*\*\*, si “*person tjetër i lidhur*”, në kuptim të nenit 3, pika 14 dhe nenit 32, pika 4 të ligjit 84/2016, si huadhënës i shumës prej 25.000 USD, si rrjedhojë nuk është përmbushur edhe detyrimi kushtetues dhe ligjor i hetimit të justifikimit të ligjshmërisë së burimit të krijimit të pasurisë (titull i ligjshëm dhe pasuri të ligjshme/neni D, paragrafi 3 i aneksit të Kushtetutës). Komisioni, për sa i përket mënyrës me të cilën ka bërë verifikimin e burimit të ligjshëm të shumës 25.000USD dhe mundësisë financiare të huadhënësit, arsyeton se: “*Nga verifikimet e kryera konfirmohet transferta bankare e sipërcituar dhe, duke qenë se ajo është kryer nga një institucion bankar në \*\*\* \*\* \*\*\*, trupi gjykues e ka vlerësuar si të panevojshëm verifikimin e mëtejshëm në lidhje me burimin e ligjshëm të kësaj shume, pasi e konsideron këtë proces si të kryer nga autoritetet kompetente të shtetit të origjinës qysh në momentin e depozitimit të kësaj shume në llogarinë bankare të huadhënësit... Në lidhje me mundësitë financiare të huadhënësit, bënë verifikime online në lidhje me shoqërinë “\*\*\*” \*\*\*, të referuar nga subjekti i rivlerësimit në sqarimet e dhëna prej tij pranë ILDKPKI-së, në datën \*\*\*.1.2016, nga ku u konfirmua ekzistenca e kësaj shoqërie, si dhe marrëdhëniet e interesit ekonomik të z. \*\*\*. \*\*\*. në shoqëri të ndryshme, si: “\*\*\* \*\* \*\*”, “\*\*\* \*\* \*\*”, “\*\*\* \*\* \*\*”, çka dëshmon për një situatë të mirë ekonomike të huadhënësit”.<sup>7</sup>*

**5.1.2/2** Në vlerësimin e Komisionerit Publik, ky arsyetim i Komisionit nuk qëndron, pasi nga gjendja e akteve në dosje rezulton që nuk është bërë verifikim i burimit të ligjshëm, sipas mjeteve dhe kërkesave të nenit 49, të ligjit 84/2016. Komisioni nisët nga një premisë e gabuar, kur shprehet se verifikimi për burimin e ligjshëm është kryer nga autoritete kompetente të shtetit të origjinës në momentin e depozitimit të kësaj shume në bankë, duke mos administruar asnjë akt apo referuar ndonjë dispozitë ligjore, ku dëshkohet se cili është

<sup>7</sup> Faqe 8 e vendimit.

autoriteti kompetent në \*\*\*, që ka bërë këtë verifikim apo e ka për detyrë ta bëjë këtë verifikim, duke hetuar ligjshmërinë e të ardhurave që kanë shërbyer për kryerjen e këtij transaksioni bankar. Në këtë drejtim, hetimi i Komisionit për të justifikuar burimin e ligjshëm të pasurisë është i paplotë.

**5.1.2/3** Sjellim në vëmendje të Kolegjit se Komisioni, në raste të ngjashme<sup>8</sup>, për persona të lidhur me subjektet e rivlerësimit, me rezidencë në \*\*\*, ka administruar akte shkresore zyrtare të plota, që provojnë ekzistencën e burimit të ligjshëm dhe të ardhurat e ligjshme, të nxjerra nga \*\*\* \*\* \*\* \*\* \*\*<sup>9</sup>. Administrimi i shpjegimeve dhe të dhënave të mësipërme dhe eventualisht rekordet e këtij personi, nëpërmjet hetimit, mund të jepnin rezultate edhe për kriterin e rivlerësimit të figurës dhe etikës për z. Arben Dollapaj.

### **(2) Veprimet fiktive për kredinë në \*\*\***

**5.1.2/4** Nga gjendja e akteve në dosje nuk rezulton të jetë hetuar lidhur me faktin nëse subjekti i rivlerësimit z. Dollapaj: (i) *së pari* përfshihej në rrethin e personave përfitues sipas vendim të Këshillit të Ministrave nr. 600/2007, (ii) *së dyti* a plotësonte kushtet për të përfituar nga kredia me kushte lehtësuese në datë \*\*\*.5.2011, (iii) *së treti* cila është procedura e ndjekur për përfitimin e saj. Këto veprime hetimore gjatë procedurës administrative do të provonin rrethanat juridike nëse subjekti i rivlerësimit mund të përfitonte këtë kredi. Disa prej akteve të administruara në dosjen e Komisionit pasqyrojnë një situatë të ndryshme nga ajo që kërkon legjislacioni përkatës për përfitimin e kësaj kredie. Më konkretisht, subjekti i rivlerësimit ka bërë vetëdeklarimin për legalizim të shtesës së katit, më datë \*\*\*11.2006, me sipërfaqe banimi 113 m<sup>2</sup>, ka pohuar nëpërmjet shpjegimeve se në momentin e përfundimit të ndërtimit janë bërë pagesat gjatë vitit 2007, si dhe ka deklaruar në deklaratat periodike nga viti 2003 - 2016 se kjo ndërtesë është adresë e vendbanimit të tij.

**5.1.2/5** Sjellim në vëmendje të Kolegjit, se Komisioni, në raste të ngjashme<sup>10,11</sup>, për faktin e marrjes kredi me kushte lehtësuese nga ana e prokurorëve, është hetuar në mënyrë të plotë duke administruar dokumentacionin e krijuar në procedurën administrative të listimit në radhën e përfituesve dhe plotësimin e kushteve, në këtë drejtim Komisioni ka hetim të mangët.

**5.1.2/6** Hetimi i këtij aspekti të kriterit të vlerësimit të pasurisë, për plotësimin e kushteve ligjore nga ana e subjektit në marrjen e kredisë së butë shtetërore, do të duhej të sillte dhe hetimin e pasojave që eventualisht ky hetim do të ketë dhe në hetimin e integritetit të subjektit të rivlerësimit, si pjesë e kontrollit të kritereve të rivlerësimit.

### **(3) Person tjetër i lidhur z. \*\*\* \*\***

**5.1.2/7** Në vlerësimin e Komisionerit Publik, Komisioni nuk ka bërë cilësimin e shtetasit z. \*\*\* \*\*\*, si “*person tjetër i lidhur*”, në kuptim të nenit 3, pika 14 dhe nenit 32, pika 4 të ligjit nr. 84/2016, për disa rrethana që, të marra së bashku, krijojnë “*marrëdhënien e interesit*” me

<sup>8</sup>Vendimi nr.\*/2018 për subjektin e rivlerësimit \*\* \*\*.

<sup>9</sup> www.irs.gov.

<sup>10</sup> Vendimin nr.\*/2018, për subjektin e rivlerësimit z. \*\* \*\*\*, pika 2.4.13 dhe 5.2. “ii” dhe “iii” e tij.

<sup>11</sup>Vendim nr. \*\*\*, datë \*\*\*.7.2018, për subjektin e rivlerësimit z. \*\* \*\*.



subjektin e rivlerësimit z. Arben Dollapaj, sipas nenit 3, pika 14 e ligjit nr. 84/2016, të cilat janë:

- Sipas aktmarrëveshjes nr.\*\*\* rep. nr.\*\*\* kol. datë \*\*\*.1.2013, janë në cilësinë e bashkëinvestitorëve dhe bashkëpronarëve në të ardhmen për ndërtimin e objektit të deklaruar si “shtëpi banimi”, në fshatin \*\*\*, \*\*\*, qarku \*\*\*.
- Sipas dokumentacionit të ZVRPP \*\*\* janë bashkëpronarë të pasurisë “shtëpi banimi”, me vendndodhje në rrugën “\*\*\* \*\*\*, \*\*\*, \*\*\*, \*\*\*.
- Sipas shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit rezulton se ai ka përdorur automjetin me targë \*\*\*, në pronësi të z. \*\*\* \*\*\*.
- Sipas deklarimeve të subjektit, gjatë hetimit administrativ të Komisionit, përgjigje datë \*\*\*.7.2017, deklarohet se prej vitit 2004, ai dhe familja e tij kanë jetuar pa qira në banesën e blerë në vitin 2004, nga vëllai i tij, z. \*\*\* \*\*\*.
- Ky i fundit pranon të njëjtin fakt (jetesën pa qira) në deklaratën noteriale nr.\*\*\* rep., nr.\*\*\* kol., datë \*\*\*.11.2006, të administruara gjatë hetimit administrativ të Komisionit.
- Deklaratë noteriale nr.\*\*\* rep., nr.\*\*\* kol., datë \*\*\*.2.2011 e shtetasit z. \*\*\* \*\*\*, ku ky i fundit pranon të njëjtin fakt.

**5.1.2/8** Lidhur me mangësitë në hetimin në drejtim “*të personit tjetër të lidhur*” z. \*\*\* \*\*\*, Komisioneri Publik çmon se nuk është përmbushur detyrimi kushtetues dhe ligjor i justifikimit të ligjshmërisë së burimit të krijimit të pasurisë (titull i ligjshëm dhe pasuri të ligjshme/neni D, paragrafi 3 i aneksit të Kushtetutës).

**5.1.2/9** Në rrethanat e mësipërme ka qenë detyrim që në referencë të dispozitave të lartpërmendura të aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, për z. \*\*\* \*\*\*, të kryej hetimi dhe vlerësimi i burimit të ligjshëm të pasurisë për blerjen e këtij sendi të paluajtshëm dhe njëkohësisht të kryheshin hetime në lidhje me rekordet e tij, të tilla që mund të jepnin rezultate për kriterin e rivlerësimit të figurës për z. Arben Dollapaj.

#### **(4) Pjesët takuese**

**5.1.2/10.** Konstatohet se subjekti i rivlerësimit, z. Arben Dollapaj, në deklaratën “Vetting” deklaroi si pjesë takuese në këtë pasuri masën 20%, ndërsa në deklaratat periodike të viteve 2007 dhe 2011 deklaroi 100%. Nuk rezulton të jetë hetuar dhe administruar ndonjë shpjegim lidhur me këtë mospërputhje.

**5.1.2/11** Po ashtu, hetimit të mëtejshëm administrativ nuk i janë nënshtruar as diferencat në sipërfaqe ndërtimi, që rezultojnë të regjistruara në kartelat e pasurisë së paluajtshme (KPP) për këtë pasuri, në krahasim me sipërfaqet e titujve të origjinës së pronësisë së subjektit të rivlerësimit.

**5.1.2/12** Duke marrë në shqyrtim dhe denoncimet e ardhura në adresë të Komisionerit Publik<sup>12</sup>, pretendohet se numri i kateve në shtëpinë e banimit të subjektit të rivlerësimit është në realitet në total 4 (katër), (3) tri kate + papafingo, në krahasim me numrin total të kateve 3 (tre), (3) tri kate + papafingo, për të cilat rezulton të jetë bazuar hetimi administrativ i Komisionit.

---

<sup>12</sup> Denoncim i datës \*\*\*.8.2018, i ardhur në mënyrë elektronike nga adresa e email-it “...”, protokolluar në KPK me nr.\*\*\* prot., datë \*\*\*.8.2018.

**(5) Hetim në lidhje me ekzistencën e situatën e konfliktit të interesave me z. \*\*\* \*\*\* dhe rekordet e këtij shtetasi**

**5.1.2/13** Për shtëpinë e banimit në rrugën “\*\*\* \*\*”, \*\*\* \*\* \*\*\*, \*\*\*, Komisioneri Publik konstaton faktin se çmimi i blerjes së banesës nga z. \*\*\* \*\*\*, me kontratën përkatëse noteriale datë \*\*\*.7.2004, për një vlerë prej 3.900.000 lekë, ka një diferencë (vlerë më të ulët) me vlerën faktike të punimeve të ndërtimit të kryera nga shitësi z. \*\*\* \*\*\*, sipas aktit të kolaudimit të datës \*\*\*.11.1998, hartuar nga ekspertja \*\*\*.\*\*\* (administruar nga Komisioni gjatë hetimit administrativ). Vlera faktike e ndërtimit sipas aktit të kolaudimit është 5.600.000 lekë.

**5.1.2/14** Nisur nga diferenca që rezulton nga vlera faktike për të cilën është ndërtuar kjo pasuri nga shtetasi z. \*\*\* \*\*\* dhe vlera për të cilën ai e ka shitur këtë pasuri te shtetasi z. \*\*\* \*\*\*, një vlerë më e vogël prej 1.700.000 lekë, nuk rezulton të jetë hetuar nga ana e Komisionit shkak i këtij trajtimi preferencial për subjektin tjetër të lidhur, z. \*\*\* \*\*\* dhe eventualisht rekordet e këtij personi (z.\*\*\* \*\*\*), në institucionet përkatëse ligjore, sikundër parashikohet në ligj. Administrimi i shpjegimeve dhe të dhënave të mësipërme, nëpërmjet hetimit, mund të japë rezultate edhe për kriterin e rivlerësimit të figurës dhe etikës për z. Arben Dollapaj.

## **5.2. Pasuria 2**

### **Shtëpi banimi në fshatin \*\*\*/\*\*\***

- Në deklaratën “*Vetting*” deklarohet: Shtëpi banimi me sipërfaqe ndërtimi të paspecifikuar, me vendndodhje në fshatin \*\*\*/\*\*\*, me vleftë 5.000.000 lekë (vlerë jo përfundimtare). Pjesët takuese në përqindje nuk janë specifikuar. Burim i krijimit të pasurisë nuk përshkruhet.

- Në deklaratën *periodike të vitit 2013* deklarohet: Kontratë për bashkinvestim dhe (njohje pronësie) për rikonstruksionin e një shtëpie me sipërfaqe 88 m<sup>2</sup>, me vendndodhje fshati \*\*\*, \*\*\*, qarku \*\*\*, me \*\*\*, \*\*\* dhe \*\*\* \*\*\*. Për vleftën është deklaruar se gjatë vitit 2013 nuk ka pasur efekte financiare, pasi nuk filluar të paguajë në zbatim të kushteve të kontratës. Pjesët takuese ¼. Burim i krijimit të pasurisë nuk përshkruhet.

- Në deklaratën *periodike të vitit 2014* deklarohet: Likuidim pjesërisht të detyrimeve nga kontrata për bashkinvestim, në vleftën 450.000 lekë. Si burim i krijimit të pasurisë (të ardhurave) është deklaruar: pakësim nga kursimet e mëparshme.

- Në deklaratën *periodike të vitit 2015* deklarohet: Likuidim pjesërisht të detyrimeve nga kontrata për bashkinvestim, në vleftën 1.150.000 lekë. Si burim i krijimit të pasurisë (të ardhurave) është deklaruar: pakësim nga kursimet e mëparshme.

- Në deklaratën *periodike të vitit 2016* deklarohet: Likuidim pjesërisht të detyrimeve nga kontrata për bashkinvestim, në vleftën 950.000 lekë. Si burim i krijimit të pasurisë (të ardhurave) është deklaruar: pakësim nga kursimet e mëparshme.

### **5.2.1 Akte të administruara në dosjen e Komisionit, ndër të tjera, janë:**

- i) Shkresë e ZVRPP \*\*\* nr.\*\*\* prot., datë \*\*\*.1.2018, për pasuritë në emër të znj. \*\*\* \*\*\*,
- ii) Kartelat (KPP) e 3 (tri) pasurive të paluajtshme në emër të znj. \*\*\* \*\*\*,
- iii) 2 vërtetime nga dokumenti hipotekor në emër të \*\*\* \*\*\*,

- iv) Kontratë shitje, pasuri të paluajtshme me nr. \*\*\* rep., nr.\*\*\* kol., datë \*\*\*.3.2007, lidhur në \*\*\* para noterit \*\*\* \*\*\*, \*\*\*. Palë shitës z.\*\*\* \*\*\* dhe palë blerës znj.\*\*\* \*\*\*, objekti shitblerje pasuria me nr.\*\*\*, z. k. \*\*\* ndërtesë njëkatëshe, trualli pronë shtet, me sipërfaqe 88 m<sup>2</sup>, me vendndodhje fshati \*\*\*, rrethi \*\*\*. Çmimi i shitjes 7000.000 lekë. Likuidimi është bërë totalisht para përpilimit të kontratës.
- v) Kontratë shitje pasuri të paluajtshme me nr.\*\*\* rep., nr.\*\*\* kol., datë \*\*\*.11.2008, lidhur në \*\*\* para noterit \*\*\* \*\*\*, palë shitës Ministria e Financës, Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave, përfaqësuar nga z.\*\*\* \*\*\* drejtor dhe palë blerëse znj.\*\*\* \*\*\*, objekti shitblerje është shitja e truallit të objektit “Mensë - kuzhinë”, pasuria me nr.\*\*\*, z. k. \*\*\*, me sipërfaqe 88 m<sup>2</sup>, me vendndodhje \*\*\*, \*\*\*. Çmimi i shitjes është 145.552 lekë. Likuidimi është bërë nëpërmjet pagesës në \*\*\* \*\*\*.
- vi) Kontratë shitje pasuri të paluajtshme me nr. \*\*\* rep., nr.\*\*\* kol., datë \*\*\*.4.2011, lidhur në \*\*\* para noterit \*\*\* \*\*\*, palë shitës Ministria e Financës, Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave, përfaqësuar nga z.\*\*\* \*\*\* drejtor dhe palë blerëse znj. \*\*\* \*\*\*, objekti shitblerje është shitja e truallit shtesë funksionale të objektit “Mensë - kuzhinë”, me sipërfaqe totale 197m<sup>2</sup>, me vendndodhje \*\*\*, \*\*\*. Çmimi i shitjes është 324.065 lekë. Likuidimi është bërë nëpërmjet pagesës në \*\*\* \*\*\*.
- vii) Aktmarrëveshje për bashkinvestim dhe bashkëpronësi me nr. \*\*\* rep., nr.\*\*\* kol., e datës \*\*\*.1.2013, lidhur në \*\*\* para noterit \*\*\* \*\*\*. Palë në marrëveshje janë shtetasit \*\*\* \*\*\*, \*\*\* \*\*\*, \*\*\* \*\*\* dhe Arben Dollapaj. Objekti i marrëveshjes është bashkëpunim dhe investim mes pronarit \*\*\* \*\*\* dhe investitorëve \*\*\*, \*\*\* dhe Arben Dollapaj. Investimi do të kryhet nga tre fëmijët e znj. \*\*\* \*\*\*. Pjesëmarrësit në këtë marrëveshje në përfundim të punimeve bien dakord të bëjnë kalimin e kësaj prone (truall dhe ndërtesë) në bashkëpronësi në pjesë të barabarta ndërmjet znj. \*\*\* \*\*\* dhe \*\*\*, \*\*\* e Arben Dollapaj.
- viii) Leje zhvillimi dhe leje ndërtimi, të datës \*\*\*.3.2013 në emër të znj. \*\*\* \*\*\*, lëshuar nga \*\*\* \*\*\*, \*\*\*. Objekti është: Rikonstruksion dhe shtesë kati.
- ix) Preventiv, objekti: Rikonstruksion dhe shtesë kati, objekti: 2 kate dhe papafingo.
- x) Shkresa nr.\*\*\* prot., datë \*\*\*.2.2018, e Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike.

**5.2.1/1** Nga aktet përcjellë nga ZVRPP \*\*\*<sup>13</sup> rezulton se nëna e subjektit, znj.\*\*\*.\*\*\*, është pronare e vetme e kësaj pasurie dhe pasuria është e regjistruar në tre tituj të veçantë pronësie. Origjina për njësinë (mensë - kuzhinë) me sipërfaqe 88 m<sup>2</sup>, rrjedh nga kontratë shitblerje nr.\*\*\* rep. nr.\*\*\* kol., datë \*\*\*.3.2007. Me kontratë shitje nr.\*\*\* rep. nr.\*\*\* kol., datë \*\*\*.11.2008<sup>14</sup>, nëna e subjektit, znj.\*\*\*.\*\*\*, ka blerë nga Drejtoria e administrimit dhe shitjes së pronave \*\*\*, truallin prej 88 m<sup>2</sup>, mbi të cilën ngrihet objekti. Ndërsa origjina e truallit funksional shtesë të objektit, me sipërfaqe 197 m<sup>2</sup>, rrjedh nga kontrata e shitjes nr.\*\*\* rep., nr.\*\*\* kol., datë \*\*\*.4.2011, blerë nga nëna e subjektit, znj.\*\*\*.\*\*\*, nga Drejtoria e administrimit dhe shitjes së pronave \*\*\*.

**5.2.1/2** Bazuar në pikën 19, neni 3 dhe nenin 32 të ligjit nr. 84/20126, nëna e subjektit, znj.\*\*\*.\*\*\*, ka deklaruar në deklaratën “Vetting”: “Një shtëpi banimi në fshatin \*\*\*, \*\*\*, sipas kontratës nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë \*\*\*.3.2007; kontratës nr. \*\*\* rep., e nr. \*\*\* kol., datë \*\*\*.11.2008; kontratës nr. \*\*\* rep., e nr. \*\*\* kol., datë \*\*\*.4.2011”. Vlera e deklaruar 700.000 lekë është vetëm vlera e objektit/njesisë, ndërkohë rezulton e padeklaruar

<sup>13</sup> Shkresë ZVRPP \*\*\* nr. \*\*\* prot., datë \*\*\*.1.2018.

<sup>14</sup> Truall të objektit mensë - kuzhinë \*\*\* \*\*\*.

vlera e blerjes së dy trojeve dhe burimi i krijimit për njësinë dhe dy trojet mbi të cilat ngrihet objekti.

**5.2.1/3** Në këto kushte, subjektit i është kërkuar të japë shpjegime, si dhe i është kaluar barra e provës<sup>15</sup> për të vërtetuar të kundërtën e gjetjeve, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, për sa vijon:

**5.2.1/4** Personi i lidhur me subjektin, znj. \*\*\*, \*\*\*, e ëma subjektit të rivlerësimit: (i) në deklaratën “Vetting” ka deklaruar shtëpinë e banimit në fshatin \*\*\*, \*\*\*, si dhe tri kontratat e shitblerjes së kësaj pasurie, por ka deklaruar si vlerë vetëm atë të blerjes së kontratës së parë prej 700.000 lekësh, por nuk ka deklaruar dy vlerat e tjera të blerjes së dy trojeve, përkatësisht 145.552 lekë, sipas kontratës së shitblerjes nr. \*\*\* rep., nr.\*\*\* kol., datë \*\*\*.11.2008, dhe 324.065 lekë, sipas kontratës së shitblerjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë \*\*\*.4.2011. (ii) Nuk ka deklaruar burimin e financimit për blerjen e pasurisë nga e ëma në vitet 2007, 2008, 2011 si person i lidhur, në vlerat: 700.000 lekë; 145.552 lekë dhe 324.065 lekë.

**5.2.1/5** Në shpjegimet e tij, subjekti sqaron: *“Jam dakord me konstatimin mbi pasaktësinë e paraqitur lidhur me mosparaqitjen e vlerave të dy kontratave të shitjes së truallit. Është deklaruar vlera e objektit, por jo vlera totale e objektit bashkë me sipërfaqen truall dhe sipërfaqen funksionale. Ka ardhur thjesht si një perceptim i vlerës së objektit. Nuk ka qëllim për të fshehur apo për të mos dhënë informacion. Janë cituar dy kontratat e blerjes së truallit dhe kontratat i janë bashkëlidhur deklaratës... Në lidhje me blerjen e shtëpisë në fshatin \*\*\*, \*\*\*, unë nuk kam kontribuar financiarisht. ...Nëna ime, në blerjen e shtëpisë, është ndihmuar nga vëllai im. Fillimisht vëllai, në muajin nëntor 2006, i ka dhënë një kapar prej 2.500 eurosh (e konfirmuar nga dokumenti bankar i Intesa Sanpaolo Bank) pronarit të shtëpisë, z. \*\*\*, \*\*\*, (shtëpi të cilën e kishte fituar nga privatizimi si ish-punonjës i Ndërmarrjes Gjeologjike). Në muajin janar 2007, vëllai i ka dhënë edhe një kapar tjetër prej 4000 eurosh (e konfirmuar nga dokumenti bankar i \*\*\* \*\*\*) Gjithashtu, dhe në pagesat për blerjen e njësisë në vitin 2007 dhe trualli (88 m<sup>2</sup>) në vitin 2008 dhe blerjes së sipërfaqes funksionale (197 m<sup>2</sup>) të truallit në 2011, nëna është ndihmuar nga vëllai im \*\*\*.\*\*\*. Kontributi i tij do të pasqyrohet në pjesëtimin e pasurisë në momentin e përfundimit të të gjitha punimeve dhe regjistrimit të kësaj pasurie”.*

**5.2.2 Në vlerësimin e Komisionerit Publik**, mangësitë e hetimit nga ana e Komisionit për këtë pasuri qëndrojnë në katër elemente: (1) cilësimit si *person tjetër të lidhur* për këtë pasuri të vëllait të subjektit të rivlerësimit, z. \*\*\* \*\*\*; (2) verifikimit të funksionit të përdorimit të ndërtesës së deklaruar si shtëpi banimi; (3) cilësimin si *person tjetër të lidhur* të motrës \*\*\* \*\*\*; (4) përllogaritja e shpenzimeve të tjera për godinën, në funksion të objektit të shfrytëzimit si strukturë hoteliere.

**5.2.2/1** Duke marrë në shqyrtim dhe denoncimet e ardhura në adresë të Komisionerit Publik, në dy<sup>16</sup> prej tyre jepen të dhëna, të cilat korrespondojnë me disa prej drejtimeve, ku hetimi i Komisionit paraqitet i mangët dhe jo i gjithanshëm dhe, më konkretisht, për sa i përket destinacionit të ndërtesës në fshatin \*\*\* dhe disa prej shkaqeve të trajtuara sa më sipër.

<sup>15</sup> Referohu akteve në dosje.

<sup>16</sup> Denoncim i datës \*\*\*.8.2018, i ardhur në mënyrë elektronike nga adresa e *email*-it “...”, protokolluar në KPK me nr.\*\*\* prot., datë \*\*\*.8.2018.

Denoncim i datës \*\*\*.11.2018, i ardhur në mënyrë elektronike nga adresa e *email*-it “...”, protokolluar në KPK me nr.\*\*\* prot., datë \*\*\*.11.2018.



Kombëtare e Biznesit, rezulton se ndërtesa në fshatin \*\*\* është me fushë veprimtarie strukturë hotelerie “*dhoma për fjetje bujtinë*”, në formën ligjore të personit fizik, në emër të subjektit z. \*\*\* \*\*\* (NIUS \*\*\*), vëllai i subjektit të rivlerësimit.

**5.2.3/2** Pra, në rast se nga Kolegji çmohen dhe hetohen këto fakte, ato eventualisht të çojnë në një konkluzion të ndryshëm nga ai i Komisionit, për sa i përket saktësisë së deklaramit të subjektit të rivlerësimit dhe një hetim i plotë do të mundësonte sqarimin e situatës juridike të kësaj ndërtese, ku subjekti i rivlerësimit është bashkinvestues dhe tërheq të drejta pronësie në ¼ pjesë takuese të kësaj ndërtese (referuar aktmarrëveshjes janar 2013). Administrimi i shpjegimeve dhe të dhënave për sa më sipër mund të jepte rezultate edhe për kriterin e rivlerësimit të etikës për z. Arben Dollapaj.

**(3) Person tjetër i lidhur zj. \*\*\* \*\*\* (\*\*\*, \*\*\*)**

**5.2.3/3** Komisioni, megjithëse ka qenë në rrethanat ligjore të vërtetuara gjatë hetimit administrativ, nuk ka bërë kualifikimin e znj. \*\*\* \*\*\* (\*\*\*, \*\*\*), si “*person tjetër i lidhur*”, në kuptim të nenit 3, pika 14 dhe nenit 32, pika 4 të ligjit nr. 84/2016, për disa rrethana që, të marra së bashku, krijojnë marrëdhënien e interesit me subjektin e rivlerësimit z. Dollapaj, sipas nenit 3, pika 14 e ligjit nr. 84/2016, të cilat janë:

- Sipas deklarimeve të subjektit të rivlerësimit, z. Dollapaj, ndër vite, ai ka marrë dhurata në formën e parave CASH nga e motra \*\*\* \*\*\* (\*\*\*, \*\*\*)
- Sipas Aktmarrëveshjes nr.\*\*\*rep., nr.\*\*\*kol., datë \*\*\*.1.2013, shfaqen si bashkinvestitor dhe bashkëpronar në të ardhmen në ndërtimin, në fshatin \*\*\*.
- Në deklarin e vitit 2003 të subjektit të rivlerësimit z. Arben Dollapaj, motra e tij, znj. \*\*\* \*\*\*, rezulton të jetë pjesë e certifikatës familjare të subjektit të rivlerësimit, z. Arben Dollapaj, deklaruar nga vetë ky i fundit.
- Kontrata e furnizimit me energji nga OSHEE për banesën në rr. “\*\*\* \*\*\*” (\*\*\*, \*\*\*), nr.\*\*\*, është lidhur në emër të shtetasës znj. \*\*\* \*\*\*.

**5.2.3/4** Me cilësimin si *person tjetër të lidhur* të znj. \*\*\* \*\*\*, duhet hetuar si për sa i përket burimit të ligjshëm të krijimit të pasurisë (likuiditete), të dhëna dhuratë subjektit të rivlerësimit, pagesës së detyrimeve tatimore për këto të ardhura.

**5.2.3/5** Po ashtu, ky hetim duhet të shtrihet për këtë person tjetër të lidhur edhe për faktet që rezultojnë nga korrespondenca me Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të Transportit Rrugor.

**5.2.3/6** Nga korrespondenca me DPSHTRR, e administruar nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, rezulton se znj. \*\*\* \*\*\* ka të regjistruar në Shqipëri automjete të blera<sup>19</sup> në shuma të konsiderueshme (27 800 USD – automjeti \*\*\*, targuar \*\*\* dhe 5 000 USD – automjeti \*\*\* \*\*\*, blerë fillimisht nga z. \*\*\* \*\*\* në \*\*\* me vlerën 27.562 USD, targuar \*\*\*<sup>20</sup>).

**5.2.3/7** Këto fakte bëjnë të domosdoshëm kryerjen e një hetimi administrativ të plotë në drejtim të personit tjetër të lidhur, znj. \*\*\* \*\*\*, edhe nëpërmjet sqarimit të rrethanave të përdorimit të këtyre mjeteve në territorin shqiptar, ndërkohë që ajo rezulton si rezidente në \*\*\*. Me interes për hetimin do të ishte dhe administrimi nga ana e AMF-së së historikut të pagesës së

<sup>19</sup> Automjeti \*\*\*, blerë në \*\*\*, sjellë në Shqipëri, automjeti \*\*\* \*\*\*, blerë në Shqipëri, i sjellë nga shitësi po nga \*\*\*.

<sup>20</sup> Rezultoni se mjeti është blerë nga shitësi \*\*\* \*\*\* në \*\*\*, në shumën 27.562 USD, në vitin 2009, dhe është paguar doganë në vlerën 659.499 lekë.

siguracionit (TPL, karton jeshil) ndër vite për këto mjete, për të konkluduar në lidhje me përdoruesit e tyre, hetim që është kryer dhe në raste të ngjashme nga ana e Komisionit.<sup>21</sup> Administrimi i shpjegimeve dhe të dhënave të mësipërme mund të jepte rezultate për kriterin e rivlerësimit të figurës dhe etikës për z. Arben Dollapaj.

#### ***(4) Përlllogaritja e shpenzimeve të tjera për godinën, në funksion të objektit të shfrytëzimit si strukturë hoteliere***

**5.2.3/8** Në rast se nga Kolegji çmohet hetimi i kësaj pasurie dhe rrethanave të tjera juridike, që lidhen me objektin e veprimtarisë për të cilën shfrytëzohet ky ndërtime (strukturë hoteliere) me rëndësi në vlerësimin e pasurisë do të ishte dhe përlllogaritja e shpenzimeve eventuale të tjera, përpos atyre për ndërtime (arredim etj.), të kryera edhe nga ana e subjektit të rivlerësimit si bashkinvestitor.

## **II.C Vlerësimi mbi dhuratat në likuiditete**

### **5.3. Dhurata nga të afërmit (motrat, kunati, vjehrri)**

- Në deklaratën periodike të vitit 2006 deklarohet: 4.000 USD dhuratë CASH nga motrat, \*\*\*, \*\*\*, \*\*\*, \*\*\*, \*\*\*, \*\*\*, \*\*\*, \*\*\*, gjatë vizitës së subjektit në \*\*\*, në dhjetor 2006 - janar 2007, për blerjen e një autoveture;
- Në deklaratën periodike të vitit 2007 deklarohet: 3.000 USD, dhuratë CASH nga motra \*\*\*, \*\*\*, në nëntor 2007;
- Në deklaratën periodike të vitit 2009 deklarohet: 300 USD, dërguar me “\*\*\*\* \*\*\*\*” nga kunati \*\*\*, \*\*\*, dhe 500 USD, dërguar me “\*\*\*\* \*\*\*\*” nga motra \*\*\*, \*\*\*,;
- Në deklaratën periodike të vitit 2013 deklarohet: 2000 USD, dërguar nga vajza e motrës, \*\*\*, \*\*\*, me “\*\*\*\* \*\*\*\*”, datë \*\*\*.6.2013, nga \*\*\*\* \*\*\*, \*\*\*, dhe 200 euro, nga vjehrri im \*\*\*, \*\*\*, me banim në \*\*\*, me “\*\*\*\*”, datë \*\*\*.6.2013;
- Në deklaratën periodike të vitit 2015 deklarohet: 500 USD, dërguar me “\*\*\*\* \*\*\*\*” nga \*\*\*, \*\*\*, datë \*\*\*.7.2015.

**5.3.1 Në vlerësimin e Komisionerit Publik**, mangësitë e hetimit nga ana e Komisionit qëndrojnë për sa i takon verifikimit të burimit të ligjshëm dhe pagesës së detyrimeve tatimore për vlerat monetare të dhuruara ndër vite subjektit të rivlerësimit, z. Arben Dollapaj.

**5.3.2** Komisioni, megjithëse ka qenë në rrethanat ligjore të vërtetuara gjatë hetimit administrativ, nuk ka bërë kualifikimin, si “*person tjetër i lidhur*”, në kuptim të nenit 3, pika 14 dhe nenit 32, pika 4 të ligjit nr. 84/2016, të personave të deklaruar në cilësinë e dhuruesit të shumave CASH në vlerat 4.000 USD, 3.000 USD dhe 2000 USD, të parashtruara më lart.

**5.3.3** Komisioni, lidhur me dhuratat nga të afërmit, në përmbajtjen e vendimit arsyeton: “...nisur nga parimi i proporcionalitetit, si dhe bazuar në bindjen e brendshme, çmon se në kushtet që vlerat monetare të dhuruara janë kryer me transferta bankare, nga institucionet bankare, një pjesë e tyre nga \*\*\*\* \*\*\*, \*\*\*, \*\*\*, si dhe rezulton se këto dhurata janë të deklaruar nga subjekti në deklaratimet periodike të pasurisë, të cilat mund të shërbejnë si provë, dhe të krijojnë bindjen se të ardhurat e dhuruesve nuk janë në atë nivel, që të çojnë në lindjen e dyshimeve për të ardhura të pajustificuara” (f. 20 e vendimit).

<sup>21</sup> Vendim nr. \*\*\*, datë \*\*\*.6.2018, i Komisionit, për subjektin e rivlerësimit z. \*\*\*\* \*\*\*.

**5.3.4** Arsyetimi i mësipërm nuk gjen mbështetje në parashikimet e dispozitave të aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016, pasi vetëm fakti i dhurimit nëpërmjet transfertave bankare nuk justifikon argumentimin se të ardhurat e dhuruara vijnë nga një burim i ligjshëm dhe për to janë paguar të gjitha detyrimet tatimore, si detyrime kumulative të parashikuara nga neni D i aneksit të Kushtetutës. Këta persona në cilësinë e tyre si dhurues, për qëllime të procesit të rivlerësimit, do të duhen të cilësohen si persona të tjerë të lidhur, në kuptim të pikës 14 të nenit 3 dhe pikës 4 të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016.

**5.3.5** Duke vepruar në këtë mënyrë, Komisioni nuk ka përmbushur detyrimin kushtetues, përcaktuar në nenin D të aneksit të Kushtetutës, pra identifikimi i atyre subjekteve që kanë deklaruar apo jo, saktësisht dhe plotësisht, pasuritë e tyre dhe të personave të lidhur me të, dhe shpjegimi bindshëm i burimit të ligjshëm i pasurisë e detyrimin e përcaktuar në nenin 32, pikat 1 dhe 4 të ligjit nr. 84/2016, ku në çdo rast kërkohet administrimi i dokumentacionit justifikues mbi vërtetësinë e deklarimeve dhe ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive.

**5.3.6** Komisioni, në përmbushje të detyrimit të parashikuar nga neni D i aneksit të Kushtetutës dhe neni 32/1/4 i ligjit nr. 84/2016, për të gjithë kategorinë e subjekteve, në cilësinë e personave të tjerë të lidhur, duhet të administronte dokumentacion ligjor, që vërteton ekzistencën e burimit të ligjshëm të krijimit të pasurisë dhe pagesës së detyrimeve tatimore për to.

## **II.D Analiza financiare e të ardhurave, shpenzimeve dhe kursimeve**

### **5.4 Metodologjia e përdorur për kryerjen e analizës**

**5.4.1** Analiza financiare/aftësia paguese e subjektit të rivlerësimit nga ana e Komisionerit Publik, për periudhën e hetuar, u mbështet në dokumentacionin e administruar gjatë hetimit administrativ nga ana e Komisionit. Analiza u bazua në verifikimin e deklarimeve të subjektit dhe të dhënave të pasqyruara në dokumentacionin e administruar si vijon:

- Të ardhurat e konsideruara të ligjshme për krijimin e pasurisë (të paluajtshme, të luajtshme, likuiditete CASH / bankë) janë të ardhurat që plotësojnë kriteret e përcaktuara në pikën 3, të nenit D të aneksit të Kushtetutës dhe të vërtetuara nga institucionet përkatëse, ku subjekti dhe personat e lidhur janë trajtuar financiarisht.
- Të ardhurat e deklaruara nga subjekti dhe të përdorura për krijimin e pasurisë, por që nuk plotësojnë kriteret e pikës 3, të nenit D të aneksit të Kushtetutës, nuk janë marrë në konsideratë.
- Deklaratat periodike të interesave ndër vite krahasuar me deklaratën “Vetting” të subjektit të rivlerësimit.
- Lëvizjet e pasqyrave bankare të subjektit dhe personave të lidhur, krahasuar me deklaratat periodike.
- Të ardhurat nga huadhënia dhe dhurimet e deklaruara u verifikuan me dokumentacionin mbështetës, për burimin e ligjshmërisë së krijimit dhe pagesën e detyrimeve tatimore.
- U llogaritën shpenzimet e kryera nga subjekti për udhëtimet jashtë shtetit, bazuar në të dhënat e administruara nga sistemi TIMS dhe deklaratat e subjektit; udhëtimet e kryera për qëllime pune nuk u morën në konsideratë si shpenzime të subjektit të rivlerësimit, pasi janë mbuluar nga institucioni.
- Për udhëtimet e kryera nga pika kufitare \*\*\*, meqenëse subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se kjo është rruga që ai ka kryer për të shkuar tek të afërmit në \*\*\* \*\*\*, shpenzimet e



udhëtimit u konsideruan në vlerën minimale të shpenzimeve të transportit, konkretisht në shumën 3,000 lekë për rrugë.

- Për shpenzimet e mobilimit dhe të shkollimit të fëmijëve u morën për bazë shpenzimet e deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratat periodike të pasurisë, shpjegimet e dhëna për Komisionin dhe dokumentacioni mbështetës.
- Pagesat e kryera për këstet e kredisë u bazuan në pasqyrat e lëvizjeve bankare të \*\*\* \*\* dhe \*\*\* dhe u krahasuan me deklaratimet e subjektit të rivlerësimit.
- Kursimet CASH të llogaritura janë bazuar në deklaratimet periodike të kryera nga subjekti i rivlerësimit, duke rillogaritur gjendjet e mbetura, në rastet kur subjekti deklaroi pagesa nga “gjendjet në banesë”.

## **5.5 Problematikat e konstatuara nga analiza financiare e subjektit të rivlerësimit**

Të ardhurat e deklaruar, për të cilat nuk është vërtetuar ligjshmëria e burimit të krijimit, janë:

- Të ardhura nga mësimdhënia në \*\*\* \*\* dhe pjesëmarrja në Këshillin e Prokurorisë, deklaruar në deklaratat periodike të viteve 2003 dhe 2008, por pa u shoqëruar me dokumentacion mbështetës (përkatësisht janë vlerat 45,000 lekë dhe 48,000 lekë).
- Hua, dhënë nga kunati z. \*\*\*.\*\*\*, në shumën 25.000 USD (nuk plotëson kushtet e nenit D, pika 3 e aneksit të Kushtetutës).
- Dhurata në të holla nga motrat, kunati dhe të afërmit, në shumën 10,300 USD dhe 200 euro, konkretisht në vitin 2006, dhuratë CASH nga motrat (4.000 USD); në vitin 2007 (3.000 USD); në vitin 2009 (300 USD) dhe (500 USD); në vitin 2013 (2000 USD) dhe (200 euro); në vitin 2015 (500 USD) (nuk plotëson kushtet e nenit D, pika 3 e aneksit të Kushtetutës).

Të ardhurat e mësipërme dhe të deklaruar nga huadhënia apo dhurimet nuk u morën në konsideratë si burime të ardhurash për krijimin e pasurive apo shtimin e likuiditeteve.

### **5.5.1 Analiza financiare në vitet me rezultat negativ**

Analiza financiare është kryer në tërësi për gjithë periudhën kohore, bazuar në metodologjinë e mësipërme, por më poshtë paraqiten vitet kur subjekti nuk ka pasur mundësi mbulimi me të ardhura të ligjshme të pasurisë, likuiditeteve dhe pagesave të kryera.

**5.5.2 Nga analiza financiare e vitit 2006** rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk mbulon me të ardhura të ligjshme kursimet e deklaruar CASH në shumën 750,000 lekë. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit deklaroi se i kanë dhuruar motrat CASH shumën prej 4000 USD. Nga analiza financiare e vitit, subjekti i rivlerësimit rezulton se ka pamundësi mbulimi me të ardhura të ligjshme në shumën 358,058 lekë (shih tab.1).

Tab.1

<b>Analiza e mbulimit të pagesave viti 2006 (në lekë)</b>	
Gjendja në bankë në fillim të vitit	107,993
Të ardhura nga pagat (SR, bashkësh., pens. i nënës)	1,241,451
<b>Totali i të ardhurave</b>	<b>1,349,444</b>
Shpenzime udhëtimi jashtë shtetit TIMS	6,000
Shpenzime jetese sipas ILDKPKI	785,715
<b>Totali i shpenzimeve</b>	<b>791,715</b>
Gjendje likuiditeti CASH (deklaruar) e vitit	750,000
Gjendja në bankë në fund	165,787
<b>Diferenca e pambuluar për pagesat dhe kursimet</b>	<b>-358,058</b>

**5.5.3 Nga analiza financiare e vitit 2007** rezulton se subjekti i rivlerësimit ka pamjaftueshmëri mbulimi për shpenzimet dhe investimet e kryera, në shumën 810,767 lekë. Bazuar në deklaratimet e subjektit ka krijuar kursime në CASH në shumën 800,000 lekë; ka investuar për shtesë kati në banesën ku jeton në shumën 1,700,000 lekë, duke pakësuar gjendjen CASH në shtëpi në shumën 1,250,000 lekë (shih tab. 2).

Tab.2

<b>Analiza e mbulimit të pagesave viti 2007 (në lekë)</b>	
Gjendja në bankë në fillim të vitit	165,787
Gjendje CASH - përdorur për shtesën e katit	1,250,000
Të ardhura nga pagat (SR, bashkësh., pens i nënës)	1,376,025
<b>Totali i të ardhurave</b>	<b>2,791,812</b>
Shpenzime jetese sipas ILDKPKI	785,714
Shpenzime udhëtimi dhe shkollimi	142,890
Pasuri investuar për shtese kati i godinës	1,700,000
<b>Totali i shpenzimeve</b>	<b>2,628,604</b>
Gjendje CASH të deklaruar në fund të vitit	800,000
Gjendja në bankë në fund të vitit	173,976
<b>Diferenca e pambuluar për pagesat dhe kursimet</b>	<b>-810,767</b>

**5.5.4 Nga analiza financiare e vitit 2008** rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur mundësi financiare për të mbuluar me të ardhura të ligjshme pagesat e kryera dhe kursimet e deklaruar. Subjekti ka deklaruar kursime CASH të vitit shumën 1,400,000 lekë. Diferenca e pambuluar për këtë vit është - 69,860 lekë (shih tab. 3).

Tab. 3

<b>Analiza e mbulimit të pagesave viti 2008 (në lekë)</b>	
Gjendja në bankë në fillim të vitit	173,976
Të ardhura nga pagat (SR, bashkësh., pens i nenës)	2,330,749
<b>Totali i të ardhurave</b>	<b>2,504,725</b>
Shpenzime udhëtimi jashtë shtetit dhe shkollimi	138,090
Shpenzime jetese sipas ILDKPKI	785,714
<b>Totali i shpenzimeve</b>	<b>923,804</b>
Gjendje CASH të deklaruar në fund të vitit	1,400,000
Gjendja në bankë në fund të vitit	250,781
<b>Diferenca e pambuluar për pagesat dhe kursimet</b>	<b>-69,860</b>

**5.5.5 Nga analiza financiare e vitit 2010** rezulton se subjekti i rivlerësimit deklaroi se ka marrë hua shumën 25,000 USD, për blerje shtëpie nga kunati i tij (z.\*\*\*.\*\*\*). Kjo shumë ka kaluar nëpërmjet transfertës bankare në \*\*\* \*\*\*, datë \*\*\*.4.2010, e cila është tërhequr nga subjekti në datë \*\*\*.6.2010, në shumën 20,000 USD dhe në datë \*\*\*.7.2010 shuma 4,900 USD. Në lidhje me këto shuma të tërhequra nga sistemi bankar, nuk gjejmë të deklaruar gjendje CASH në banesë, në deklaratën periodike të interesave të vitit 2010, por vetëm deklarimin e subjektit të rivlerësimit për huan ndaj kunatit. Ndërkohë, subjekti i rivlerësimit ka pasur detyrimin ligjor të deklaronte gjendjen CASH në banesë në fund të vitit. Për këtë çështje rezulton se Komisioni nuk ka hetuar.

**5.5.6 Nga analiza financiare e vitit 2011** rezulton se subjekti i vlerësimit ka konsideruar si të ardhur huan e mësipërme. Në analizën financiare të Komisionerit Publik, vlera e kësaj huaje prej 25.000 USD, nuk është marrë në konsideratë, pasi nuk është vërtetuar ligjshmëria e burimit dhe të ardhurave. Analiza e vitit 2011 paraqitet në tabelën më poshtë (shih tab. 4)

Tab. 4

<b>Analiza e mbulimit të pagesave viti 2011 (në lekë)</b>	
Gjendja në bankë në fillim të vitit	128,938
Të ardhura nga pagat dhe puna, subjekti	2,861,788
Pakësuar gjendja CASH në banesë (deklaruar)	1,500,000
Marrë kredi pranë ***	4,950,000
<b>Totali i të ardhurave</b>	<b>9,440,726</b>
Shpenzime udhëtimi jashtë shtetit dhe shkollim	337,584
Shpenzime jetese sipas ILDKPKI-së	785,715
Shpenzime shlyerje kredie *** (principal + interes) dhe kredi konsumatore	331,996
Shtuar pasuria, paguar blerje apartamenti	9,000,000
<b>Totali i shpenzimeve</b>	<b>10,455,295</b>
Gjendje likuiditeti CASH (deklaruar) e vitit	1,100,000
Gjendja në bankë në fund të vitit	183,939
<b>Diferenca e pambuluar për pagesat dhe kursimet</b>	<b>-2,298,509</b>

Në këtë vit, subjekti i rivlerësimit, nga verifikimi i pasqyrave të lëvizjeve bankare, ka kaluar me xhirim<sup>22</sup> në llogarinë e \*\*\* \*\* shumën 4,950,000 lekë.

**5.5.7 Nga analiza financiare e vitit 2013**, bazuar në deklaratimet e subjektit, në deklaratën periodike të vitit 2013, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se ka paguar detyrimin ndaj kumatit CASH në shumën 5000 USD, nga pakësimi i gjendjes në banesë. Në këtë vit subjekti i rivlerësimit ka kryer shpenzime për udhëtime jashtë shtetit, ka deklaruar kursime nga pagat në shumën 850,000 lekë, ka deklaruar shpenzime arredimi në shumën 249,000 lekë. Gjithashtu, subjekti deklaron se këtë vit ka marrë dhuratë në shumën 2000\$ nga motra, në \*\*\* dhe 200\$ nga vjehri, në Shqipëri, të ardhura të pahetuara në kuptim të nenit D/3 të aneksit të Kushtetutës (shih tab. 5).

Tab. 5

<b>Analiza e mbulimit të pagesave viti 2013 (në lekë)</b>	
Gjendja në bankë në fillim të vitit	253,453
Të ardhura nga pagat dhe puna, subjekti	2,557,128
Pakësuar gjendja CASH në banesë	300,000
<b>Totali i të ardhurave</b>	<b>3,110,581</b>
Shpenzime arredimi	249,000
Shpenzime udhëtimit jashtë shtetit	392,560
Shpenzime jetese sipas ILDKPKI-së	785,715
Shpenzime shlyerje kredie *** (principal + interes)	473,671
Pagesë për shlyerje borxhi kumatit 5000\$ (paguar CASH)	509,300
<b>Totali i shpenzimeve</b>	<b>2,410,246</b>
Gjendje likuiditeti CASH (deklaruar) e vitit	850,000
Gjendja në bankë në fund të vitit	476,286
<b>Diferenca e pambuluar për pagesat dhe kursimet</b>	<b>-625,951</b>

Diferenca e pambuluar e subjektit për këtë vit është -625,951 lekë, pra subjekti nuk ka pasur mundësi financiare të kursente shumën e deklaruar 850,000 lekë në këtë vit.

## **5.6 Çështje të tjera të konstatuara gjatë verifikimit të deklaratave periodike të interesave**

**5.6.1** Nga verifikimi i pasqyrave të lëvizjeve bankare konstatojmë se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në deklaratat periodike vjetore nga viti 2007 e në vazhdim llogaritë bankare në lekë, euro dhe USD, për vete dhe bashkëshorten. Subjekti i rivlerësimit ka pasur detyrimin të deklaronte shtesat dhe pakësimet e gjendjeve CASH apo në bankë në fund të çdo viti deklarues (shih tab. 6).

<sup>22</sup> Transferta e \*\*\*, datë \*\*\*.5.2011, kaluar si detyrim për blerje apartamenti \*\*\*. \*\*\*

Tab. 6

Llogaritë e padeklaruara dhe gjendjet e tyre paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Periodha	Llogaritë e subjektit të rivlerësimit				Llogaritë e bashkëshortes					Shuma e padeklaruar ALL	
	*** *** ALL	*** rrjedhëse ALL	***	***/**	*** SR/ALL	*** USD	*** /ALL	*** llogari kursimi	Procred it Eur.		Procredit ALL kursimi
	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	
31.12.2007			75,679						63,186		<b>173,976</b>
31.12.2008	41,240		182,490				1,953		66,337		<b>292,021</b>
31.12.2009	10,640		30,800				4		76,984		<b>118,428</b>
31.12.2010	10,040		7,597		23,643	6,656	10,829		80,212		<b>138,978</b>
31.12.2011	4,440	13,271	7,597		1,197	0	6,054		81,610	68,626	<b>182,795</b>
31.12.2012	3,840	54,902	7,597		1,186	0	41,788		0	60,277	<b>169,590</b>
31.12.2013	3,240	108,406	7,598		198,433	0	9,829		0	64,113	<b>391,619</b>
31.12.2014	2,640	204,316	7,599		348,567	0	509			67,632	<b>631,264</b>
31.12.2015	2,040	307,207	7,599		323,091	0	70			4,752	<b>644,759</b>
31.12.2016	0	15,825	6,850		383,902		1,991			0	<b>408,568</b>

**5.6.2** Gjithashtu, nga verifikimi i pasqyrave të lëvizjeve bankare, konstatojmë se subjekti ka depozituar CASH në llogarinë në euro, pranë \*\*\*, shumat 7000 euro në datë \*\*\*.1.2017 dhe 2,400 euro në datë \*\*\*.1.2017. Pra, gjithsej shuma 9400 euro ose e konvertuar në lekë 1,282,066 lekë. Meqenëse veprimi bankar është kryer në fillim të vitit 2017, kjo shumë duhet të ishte gjendje CASH në fund të vitit 2016 dhe subjekti ka pasur detyrimin për ta deklaruar në deklaratën periodike të vitit 2016.

**5.6.3** Në vlerësimin e Komisionerit Publik, përfundimet që do të arrihen në lidhje me klasifikimin e personave të tjerë të lidhur, hetimi i burimit të ligjshëm dhe pagesa e detyrimeve tatimore për të ardhurat që ka deklaruar subjekti i rivlerësimit, si të përfituara nga personat e tjerë të lidhur, të trajtuar më lart në këtë ankim, do të ndikojnë detyrimisht në analizën e përgjithshme financiare të subjektit, me qëllim kontrollin e përmbushjes së detyrimeve që parashikon neni D i aneksit të Kushtetutës. Hetimi në lidhje me ndikimin eventual të trajtimit të këtyre të ardhurave në analizën e përgjithshme financiare është me rëndësi në vlerësimin e Komisionerit Publik.

### III. Kërkimi i ankimit

**6.1** Duke ritheksuar se Komisioneri Publik, me qëllim garantimin e mbrojtjes së interesit publik në procesin e rivlerësimit, ka të drejtën dhe detyrimin e ushtrimit të kontrollit ndaj vendimeve të dhëna nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, duke vlerësuar nëse vendimmarrja bazohet në një hetim të plotë dhe të gjithanshëm dhe çmim të drejtë të provave të administruara;

**6.2** Në konsideratë të trajtimit të shkaqeve të ankimit, bazuar në parashikimet e nenit 179/b (5) të Kushtetutës, neni C (2), Ç, D, Dh, E dhe F (7), të aneksit të Kushtetutës, ndryshe nga sa disponon Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, referuar gjendjes së fakteve dhe provave të administruara nga Komisioni, Komisioneri Publik nuk krijon bindjen se për subjektin e rivlerësimit gjen zbatim neni 59/1 i ligjit nr. 84/2016;

**6.3** Mbështetur në parashikimin e nenit F, pika 3 dhe 7, e aneksit të Kushtetutës, nenit 66 të ligjit nr. 84/2016, kërkohet që shkaqet e parashtruara në këtë ankim të merren në konsideratë nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelit dhe, pas hetimit të plotë të kriterëve të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, z. Arben Dollapaj, në përfundim të gjykimit të çështjes, të vendosë:

- Lënien në fuqi të vendimit nr. 63, datë 6.8.2018 ose
- Ndryshimin e vendimit nr. 63, datë 6.8.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit, z. Arben Dollapaj.

## **KOMISIONERI PUBLIK**

**Florian BALLHYSA**